



Australian Government

COVID-19
VACCINATION

Informacione mbi AstraZeneca

Vaksina AstraZeneca

Ekziston një lidhje midis vaksinës AstraZeneca dhe një gjendje mjekësore të rrallë, e cila përfshin koagulimin e gjakut dhe nivelin e e ulët të trombociteve pllakëzave të gjakut. Gjendja mjekësore quhet trombozë me sindromën trombocitopeni (TTS).

Vaksinimi kundër COVID-19 rekomandohet për të gjithë personat e rritur. Vaksina Pfizer është vaksina e preferuar kundër COVID-19 për personat e rritur nën 60 vjeç. Megjithatë, personat e rritur nën moshën 60 vjeç ende mund të zgjedhin të marrin vaksinën AstraZeneca. Bisedoni me mjekun tuaj për t'ju ndihmuar të merrni vendimin.

Vaksina AstraZeneca do t'u jepet njerëzve të moshës mbi 60 vjeç.

Çfarë është tromboza me sindromën trombocitopeni (e njohur si TTS)?

Tromboza nënkupton mpiksjen e gjakut.

Trombocitopenia nënkupton nivel të ulët të trombociteve (pllakëzave) të gjakut.

TTS është një efekt anësor i rrallë i vaksinës AstraZeneca. Nëse ndodh, mund të jetë serioze dhe mund të shkaktojë paaftësi ose vdekje. TTS shkakton mpiksje të gjakut që mund të ndodhin në pjesë të ndryshme të trupit. Mund të shkaktojë gjithashtu numër të ulët të trombociteve në gjak, gjë që mund të rezultojë në gjakderdhje. Nuk ka asnjë lidhje midis vaksinës Pfizer dhe TTS.

Kur ndodh TTS?

Rastet e raportuara të TTS kanë ndodhur nga dita e 4 deri në ditën e 42 pas vaksinimit, zakonisht me dozën e parë të vaksinës AstraZeneca.

Sa e shpeshtë është TTS?

TTS ndodh rrallë. Aktualisht vlerësohet se prek diku 1-2 për 100,000 njerëz që kanë marrë vaksinën AstraZeneca kundër COVID-19. Për njerëzit nën 60 vjeç, niveli vlerësohet të jetë më i lartë diku 2-3 njerëz nga 100,000 njerëz. Këto vlerësime do të azhurnohen sa më shumë informacione të jenë në dispozicion.

A ka grupe që janë më të rrezikuara nga TTS?

TTS duket të jetë më e zakonshme tek personat e rinj në moshë, edhe pse është raportuar gjithashtu tek disa të rritur më të mëdhenj në moshë. Ne nuk e dimë nëse ka ndonjë gjendje mjekësore ekzistuese që mund të kontribuojë në mpiksjen e gjakut. Hulumtuesit po hetojnë këtë.

Cilat janë simptomat e TTS?

TTS mund të shkaktojë disa nga simptomat e mëposhtme:

- një dhimbje e rëndë koke e vazhdueshme që:
 - shfaqet të paktën 2 ditë pas vaksinimit
 - nuk përmirësohet me ilaçe të thjeshta kundër dhimbjeve
 - mund të përkeqësohet kur shtriheni
- të përziera dhe të vjella
- shikim të turbullt
- vështirësi në të folur
- përgjumje
- kriza
- vështirësi në frymëmarrje
- dhimbje gjoksi
- ënjtje të këmbëve
- dhimbje të vazhdueshme të stomakut
- njolla të vogla gjaku nën lëkurë, në largësi nga vendi i injektimit.

Nëse ju ose një person tjetër shfaqni ndonjë nga këto efekte anësore serioze pas vaksinimit kundër COVID-19, ju duhet të telefononi menjëherë në 000.

A janë përfitimet e vaksinës AstraZeneca më të mëdha se rreziqet?

Po. Përfitimet e vaksinimit janë më të mëdha sesa rreziqet, veçanërisht për njerëzit e moshuar që janë më të rrezikuar për t'u sëmurë rëndë nga COVID-19.

Po nëse jeni nën 60 vjeç dhe duhet të merrni dozën e parë të AstraZeneca?

Nëse duhet të merrni dozën e parë të vaksinës AstraZeneca dhe jeni nën 60 vjeç, bisedoni me mjekun tuaj. Ai do t'ju ndihmojë të vendosni nëse do të merrni vaksinën.

Po nëse keni marrë dozën e parë të AstraZeneca dhe duhet të merrni dozën e dytë?

Pothuajse të gjitha rastet e raportuara të TTS kanë ndodhur pas dozës së parë të vaksinës AstraZeneca kundër COVID-19. Nëse nuk keni pasur efekte anësore të rënda pas dozës së parë të vaksinës AstraZeneca, mund të jeni të sigurt në marrjen e dozës së dytë, edhe nëse jeni nën 60 vjeç.

A është vakcina AstraZeneca e sigurt për njerëzit që kanë pasur mpiksje gjaku në të kaluarën?

Mund të bëni vaksinën AstraZeneca edhe nëse keni pasur lloje të tjera të mpiksjes së gjakut në të kaluarën ose nëse jeni të rrezikuar për mpiksje të gjakut. Nuk ka dëshmi se ekzistenca e një mpiksje të mëparshme të gjakut rrit rrezikun e TTS pas marrjes së vaksinës AstraZeneca.

Për më shumë informacion

Nëse keni pyetje në lidhje me vaksinën AstraZeneca, bisedoni me mjekun tuaj, vizitoni www.health.gov.au/covid19-vaccines-languages ose telefononi Linjën Kombëtare për Koronavirusin në 1800 020 080. Për shërbime përkthimi dhe interpretimi, telefononi në 131 450.